



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 63

Prishtinë, më 22.12.2016, në orën 22:30

Ndërtesa e Kuvendit, S-2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Njomza Emini, , Xhavit Haliti ,Arben Gashi, Fatmir Xhelili, Bislam Zogaj, Donika Kadaj-Bujupi, Kujtim Paçaku ,Slobodan Petroviç dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Vjosa Osmani, Valdete Bajrami,.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Ahter Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi Njomza Emini, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.**

Kryetarja e Komisionit pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen .

Njoftoj se në shqyrtim është Projektligji nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, me amendamentet e Komisionit Funksional. Lidhur me opinionin ligjor të këtij projektligji ,ajo tha se ky projektligj nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacion të BE-së, Pra, shtetet anëtare të BE-së këtë fushë e mbulojnë me legjislacionin e tyre kombëtar ,andaj propozoi që të procedohet për miratim në Kuvend për lexim të dytë .

Hapi diskutimin!

Kujtim Paçaku tha se do të abstenoj gjatë votimit ,sepse nuk ishte përfshirë kërkesa e tij në buxhet , lidhur me një projekt për komunitetin rom, shtoi se edhe vitin e kaluar në asnjë linjë buxhetore nuk ishte përfshirë komuniteti rom.

Pas votimit kryetarja konstatoj se Komisioni me shumicë votash nxori këtë ;

Rekomandim

1. Projektligji nr.05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, me amendamentet e Komisionit funksional nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe si i tillë mund te rekomandohet për miratim ne Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 23:00.

E përgatiti

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Njomza Emini